



Pranuar / Dorezuar Punëjeto/Prodato Received/Deliverty	25.05.2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHCK	3046/2022		1/4



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
 NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
 INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.292/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Jeton Koca-kryetar, Arditë Haxhnikaj Demi dhe Arben Mehmeti-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.292/2022 të datës 28.03.2022, të parashtruar nga ankuesi _____ me adresë _____ kundër organit të punësimit/Policia e Kosovës, në çështjen juridike “transferim i përkohshëm”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 25.05.2022, në mënyrë unanime mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa A.nr.292/2022 e datës 28.03.2022 e parashtruar nga ankuesi _____

II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër reference 07/1-01SAP-P/0503 i datës 28.01.2022 i Drejtorit të Drejtorisë Personelit të Policisë së Kosovës.

A r s y e t i m

Ankuesi _____ i punësuar në Policinë e Kosovës, me datë 28.03.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 1624/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër 07/1-01SAP-P/0503 të datës 28.01.2022 të Drejtorit të Drejtorisë së Personelit të Policisë së Kosovës, me të cilin vendim është bërë sistemimi për kohë të caktuar i ankuesit nga pozita e Zyrtarit të bazë së të dhënave në pozitën Zyrtar i Personelit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duke u bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur

Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 04.04.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Policinë e Kosovës, ndërsa me datën 15.04.2022 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me provat e lëndës.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për shkak të natyrës së çështjes, me datë 11.05.2022 ka nxjerrë Vendimin me numër VK.nr.42/2022, me të cilin është vazhduar afati edhe për dhjetë (10) dite pune lidhur me ankesës A.nr.292/2022 të datës 28.03.2022..

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave për vendosje meritore ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 1624/2022 të datës 28.03.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Vendimin me numër KDNSHC-05/006/2022 të datës 07.03.2022 të Komisioni Disiplinor për Nëpunësit e Shërbimit Civil në Policinë e Kosovës; Vendimin me numër 07/1-01SAP-P/0503 të datës 28.01.2022 të Drejtorisë së Personelit në Prishtinë; Ankesën e ankuesit të datës 07.02.2022 për në Komisionin e Ankesave të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë në Prishtinë; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 04.04.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen e datës 15.04.2022 nga Policia e Kosovës me provat e bashkangjitura të lëndës; Kontratën e punës së ankuesit me numër reference 07/1/01A/0549 të datës 23.05.2005; Formularin PDP mbi përshkrimin e detyrave të punës për pozitën zyrtar i personelit të datës 02.06.2015; E-mailat zyrtar të datës 27.01.2022, 26.01.2022, 25.01.2022; Vendimin me Nr.prot.321/2021 të datës 30.03.2021 nga Agjencia e Kosovës për Inteligjencë; Draft raportin e inspektimit me numër Nr.9/2021 nga Ministria e Punëve të Brendshme, Inspektorati Policor i Kosovës-Departamenti i Inspektiveve; Vendimin me numër VK.nr.42/2022 të datës 10.05.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mailat zyrtar të datës 10.05.2022; Kërkesën e datës 19.05.2022 për prova shtese nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës së bashku me përgjigjen e datës 19.05.2022 nga Policia e Kosovës lidhur me kërkesën për prova shtese; Vendimin me numër Nr.Ref.06-200-2021 të datës 25.02.2021 nga Agjencia e Kosovës për Inteligjencë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankuesit është e pa bazuar, sepse:

Nga administrimi i provave të lëndës përkatësisht sipas Kontratës së Punës më Nr. reference 07/1-01A/0549, rrjedhe së ankuesi është i punësuar në Policinë e Kosovës në pozitën e punës *Zyrtar në Bazën e të Dhënave* në Zyrën e SIPK-ut pranë Drejtorisë Rajonale të Policisë në Pejë. Me datë 28.01.2022, Drejtori i Drejtorisë së Personelit të Policisë së Kosovës ka nxjerrë Vendimin Nr. reference 07/1-01SAP-P/0503, me të cilin ankuesi është sistemuar për kohë të caktuar nga pozita Zyrtar i bazës së të dhënave në pozitën Zyrtar i Personelit në Zyrën për Personel dhe Administratë-Drejtoria Rajonale në Pejë, për periudhën nga data 29.01.2022 deri me 28.07.2022, me arsyetimin se ankuesi nuk ka mundur të pajiset me certifikatë të sigurisë nga Agjencia e Kosovës për Inteligjencë (me teje AKI) dhe duhet të largohet nga pozita të cilën e ka mbajtur.

Ankuesi i pakënaqur me Vendimin me numër reference 07/1-01SAP-P/0503 të datës 28.01.2022, ka parashtruar ankesë me datë 28.03.2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore se transferimi i ankuesit është bërë pa vullnetin e tij dhe si i tillë është i pa bazuar.

Në kuptim të dispozitave të Ligjit Nr.03/178 për Klasifikimin e Informacioneve dhe Verifikimin e Sigurisë si dhe Rregullores NR.16/2011 për Zhvillimin e Procedurës së Verifikimit të Sigurisë e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren Nr.36/2011, të gjithë të punësuarit në institucionet publike të Republikës së Kosovës të cilët kanë qasje, administrojnë apo qarkullojnë informacione të klasifikuara gjatë ushtrimit të detyrave të tyre zyrtare, duhet të pajisjen me leje të sigurisë nga autoriteti kompetent gjegjësisht nga Agjencia Kosovare e Inteligjencës, e mbi këtë bazë ligjore dhe duke marrë parasysh faktin se ankuesi ushtron pozitën e Zyrtarit për Bazën e të Dhënave, organi i punësimit-Policia e Kosovës ka parashtruar kërkesë në AKI për zhvillimin e procedurës së verifikimit të sigurisë dhe pajisjes së ankuesit me leje të sigurisë për nivelin konfidencial ku siç u konstatuar me lartë një leje e tillë ishte refuzuar nga AKI-ja, andaj edhe nxjerrja e Vendimit të kundërshtuar me ankesë ka ardhur si rezultat i Vendimit Nr.Ref.06-200-2021 të datës 25.02.2021 të Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë me të cilin ankuesit i është refuzuar dhënia e lejes së sigurisë për nivelin konfidencial.

Përkitazi me ligjshmërinë e Vendimit 07/1-01SAP-P/0503 të datës 28.01.2022, Kolegji po ashtu ka analizuar nenin 22 të Ligjit Nr.03/178 për Klasifikimin e Informacioneve dhe Verifikimin e Sigurisë me të cilin është përcaktuar se: 1. Një person mund të ketë qasje në informacione të klasifikuara si "KONFIDENCIALE", "SEKRET" ose "TEPËR SEKRET" me kusht që ai person: 1.1. të ketë leje të vlefshme mbi sigurinë; 1.2. të ketë nevojë për të qenë në dijeni të këtyre informacioneve që ta kryejë misionin apo detyrën e tij/saj zyrtare; dhe 1.3. të ketë nënshkruar deklaratën e konfidencialitetit, andaj, Kolegji duke u bazuar në të gjeturat dhe konstatimet si me lart, vlerëson se organi i punësimit ka vepruar në pajtim me nenin 25 paragrafin 3 të Ligjit Nr.03/178 për Klasifikimin e Informacioneve dhe Verifikimin e Sigurisë me të cilin është përcaktuar se: Çdo institucion publik i bindet vendimit të Autoritetit Verifikues dhe nuk i jep qasje në informacione të klasifikuara një personi të cilit i është refuzuar leja e sigurisë si dhe neni 27 paragrafi 7 të të njëjtit ligj ku shprehimisht theksohet se: Mos marrja e lejes së sigurisë rezulton me transferimin e personit zyrtarit në një pozitë tjetër të baras vlefshme për të cilën nuk nevojitet verifikimi i sigurisë..., kështu që mbi këto arsye Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave konstaton se organi i punësimit me rastin e nxjerrjes së Vendimit 07/1-01SAP-P/0503 të datës 28.01.2022 për transferimin e përkohshëm të ankuesit ka vepruar edhe në harmoni me dispozitën e nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, rrjedhimesh në këtë kuptim rezulton se janë të pabazuara pretendimet ankimore të ankuesit.

Bazuar si me lartë, Kolegji pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.


Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.




Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.292/2022

Flakron Gashi


Procesmbajtës

Jeton Koca


Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës;
- Drejtorit të Drejtorisë së Personelit të Policisë së Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

